



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU DEJËS

KRYETARI

Nr. 7433 Prot

Vau Dejës, me 17.12.2024

URDHËR
Nr. 771 datë 17.12.2024

**PËR
MIRATIMIN E RREGULLORES PËR HETIMIN
ADMINISTRATIV TË SINJALIZIMIT DHE MBROJTJEN E KONFIDENCIALITETIT
NË BASHKINË VAU DEJES**

Në mbështetje të nenit 8 kreu III të ligjit nr.139 /2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, në zbatim të Ligjit 60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”, i ndryshuar; të VKM nr.816 datë 16.11.2016 “Për strukturën, kriteret e përzgjedhjes dhe marrdhëniet e punës së punonjësve të njësisë përgjegjëse në autoritetet publike, në zbatim të Ligjit 60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”;

URDHËROJ:

1. Miratimin e rregullores “Për hetimin administrativ të sinjalizimit dhe mbrojtjen e konfidencialitetit në bashkinë Vau Dejës”, bashkëlidhur këtij urdhëri.
2. Me këtë urdhër të njihet i gjithë personeli drejtuesi i bashkisë dhe njësisë vartëse.
3. Për zbatimin e këtij urdhëri ngarkohet Njësia Përgjegjëse për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve në Bashki.
4. **Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.**

KRYETARI

Kristian SHKRELI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VAU DEJËS

RREGULLORE E BRENDSHME
PER HETIMIN ADMINISTRATIV TE SINJALIZIMIT DHE MBROJTJEN E
KONFIDENCIALITETIT NË BASHKINË VAU DEJES

KREU I
RREGULLA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Baza ligjore

Rregullorja për hetimin administrativ të sinjalizimit dhe mbrojtjen e konfidencialitetit në Bashkinë Vau Dejes, bazohet në ligjin nr. 60/2016, “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”, i ndryshuar, Kodin e Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, si dhe në bazë të urdhërave, udhëzimeve dhe akteve të tjera nënligjore të nxjerra në zbatim të tyre. .

Neni 2

Objekti

Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave për procedurën e shqyrtimit të hetimit administrativ të sinjalizimit dhe përcaktimin e mekanizmave të mbrojtjes së konfidencialitetit në zbatim të ligjit nr. 60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve” i ndryshuar.

Neni 3

Përkufizime

Në këtë Rregullore termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “I sinjalizuar” janë një ose më shumë persona, ndaj të cilëve bëhet një sinjalizim, sipas këtij ligji, në lidhje me një veprim ose praktikë të dyshuar korrupsioni.
2. “Njësia përgjegjëse” është organi i posaçëm, i caktuar brenda autoritetit publik ose subjektit privat, i përbërë nga një ose më shumë punonjës të organizatës dhe i ngarkuar me detyrën e shqyrtimit të hetimit administrativ të sinjalizimit dhe shqyrtimin e kërkesës për mbrojtjen e

sinjalizuesit, sipas përcaktimeve të këtij ligji.

3. “Organizatë” është autoriteti publik ose subjekti privat.

4. “Sinjalizim” është raportimi i informacionit nga ana e sinjalizuesit tek njësia përgjegjëse për veprime apo praktika të dyshuara korrupsioni, të kryera në vendin e tij të punës në autoritetin publik apo subjektin privat.

5. “Sinjalizues” është individ, i cili aplikon ose është në marrëdhënie pune, ose ka punuar më parë pranë autoritetit publik apo subjektit privat, pavarësisht nga natyra e marrëdhënies së punës ose kohëzgjatjes së saj, si dhe nëse paguhet ose jo, që sinjalizon një veprim ose praktikë të dyshuar korrupsioni.

6. “Subjekt privat” është personi juridik privat, sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, përfshirë tregtarin, sipas ligjit për tregtarët dhe shoqëritë tregtare.

7. “Veprim ose praktikë e dyshuar korrupsioni” është një veprim ose mosveprim, fakte ose rrethana të kryera në një organizatë, për të cilat sinjalizuesi dyshon në mirëbesim, sipas këtij ligji, se mund të përbëjë korrupsion.

8. “ILDKPKI” është Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave.

KREU II

VEPRIMTARIA E BASHKISE VAU DEJES

Neni 4

Parimet e veprimtarisë

1. Njesia përgjegjëse për zbatimin e ligjit nr. 60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve” i ndryshuar, bazohet në parimin e:

- a. ruajtjes së konfidencialitetit të informacionit të sinjalizimit dhe sekretit shtetëror;
- b. njohjes së identitetit të sinjalizuesit, përveç rastit kur ligji lejon pranimin e një sinjalizimi anonim;
- c. sinjalizimit vullnetar të një veprimi ose praktike të dyshuar të korrupsionit;
- d. integritetit dhe paanshmërisë gjatë shqyrtimit të sinjalizimit;
- e. zbatimit të mekanizmave të efektshëm dhe të përshtatshëm për mbrojtjen e të drejtave dhe

interesave legjitimë të sinjalizuesit;

f. procedurës së hetimit administrativ të sinjalizimit në mënyrë të shpejtë dhe të besueshme.

KREU III

PROCEDURAT E VEPRIMIT

Neni 5^{L1}_{SEP}

Kryerja e veprimeve procedurale

1. Veprimet procedurale të njesise përgjegjese kryhen në përputhje me ligjin nr. 60/2016 dhe në rast të mosparashikimit nga ky ligj sipas Kodit të Procedurave Administrative.
2. Njoftimet për veprimet procedurale, për të cilat njesia përgjegjese cakton afate, duhet të përmbajnë paralajmërimin e shprehur mbi pasojat e mosrespektimit të afatit.

Neni 6^{L1}_{SEP}

Forma dhe përmbajtja e sinjalizimit

1. Sinjalizimi bëhet me çdo mjet komunikimi, në formë të shkruar ose deklarohet verbalisht para njesise përgjegjese dhe dokumentohet me shkrim prej këtij të fundit.
2. Sinjalizimi përmban të paktën:
 - a. të dhënat e identitetit të sinjalizuesit;
 - b. të dhënat e kontaktit të sinjalizuesit;
 - c. përshkrimin e fakteve të rrethanave të njohura nga sinjalizuesi për veprimin ose praktikën e dyshuar të korrupsionit, shoqëruar me provat përkatëse, për aq sa është e mundur;
 - d. referimin përkatës në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë, për aq sa është e mundur, nga sinjalizuesi, të veprës ose praktikës së dyshuar të korrupsionit;
 - e. në rastin e sinjalizimit tek njesia përgjegjese shkaqet ligjore dhe rrethanat e faktit, për aq sa është e mundur, nga sinjalizuesi, për përdorimin e mekanizmit të sinjalizimit të jashtëm.
3. Sinjalizuesi mund të zgjedhë të mbetet anonim dhe sinjalizimi pranohet nga njesia përgjegjese si i tillë, vetëm nëse në të janë shprehur qartë dhe janë arsyetuar shkaqet e anonimatit dhe të dhënat e sinjalizuara sigurojnë një bazë të mjaftueshme për të hetuar

administrativisht veprimin ose praktikën e dyshuar të korrupsionit.

4. Në rastet kur sinjalizimi nuk është depozituar sipas formës dhe përmbajtjes së mësipërme sinjalizuesit i kërkohet me shkrim të korrigjojë këto të meta brenda 7 ditëve nga data e marrjes së njoftimit për korrigjim.

Neni 7

Mosfillimi i hetimit administrativ

1. Njesia përgjegjëse ka të drejtë të mos fillojë hetimin administrativ nëse;

a. sinjalizimi nuk është depozituar sipas formës dhe përmbajtjes së kërkuar dhe sinjalizuesi nuk korrigjon këto të meta brenda 7 ditëve nga data e marrjes së njoftimit për korrigjim;

b. sinjalizimi përmban fakte dhe rrethana që nuk përfshihen në fushën e zbatimit të ligjit nr. 60/2016, sipas nenit 3, pika 6, të tij;

c. kur nga përmbajtja e sinjalizimit del haptazi se nuk ka elemente të kundërvajtjes administrative ose të veprës penale.

2. Mosfillimi i hetimit administrativ bëhet me vendim të arsyetuar të njesise përgjegjëse të Sinjalizimit të bashkise .

Neni 8

Hetimi i drejtpërdrejtë nga ILDKPKI

1. ILDKPKI heton drejtpërdrejt sinjalizimin për veprimet ose praktikën e dyshuara të korrupsionit në organizata, të cilat nuk kanë një njësi përgjegjëse për këtë qëllim.

2. Pavarësisht nga përcaktimi i pikës 1 të këtij neni, sinjalizuesi ka të drejtë të sinjalizojë veprën e dyshuar të korrupsionit tek ILDKPKI në rastet kur;

a. njesia përgjegjëse nuk fillon hetimin administrativ ose përfundon hetimin në kundërshtim me nenin 14 të ligjit nr. 60/2016;

b. ekziston dyshimi i arsyeshëm se pritësi i sinjalizimit në njësinë përgjegjëse ose persona të lidhur me të janë të përfshirë ose kanë një interes të drejtpërdrejtë ose jo të drejtpërdrejtë, pasuror ose personal, në veprimin ose praktikën e dyshuar të korrupsionit. Sipas rastit, person i lidhur ka të njëjtin kuptim me përcaktimet e bëra në ligjin për tregtarët dhe shoqëritë tregtare ose ligjin për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e

funksioneve publike;

c. ka arsye të tjera të bazuara për të dyshuar në integritetin dhe paanshmërinë e njësisë përgjegjëse në shqyrtimin e sinjalizimit;

d. prova e sinjalizuesit, në lidhje me veprimin ose praktikën e dyshuar të korrupsionit, mund të fshihet ose të shkatërrohet nga organizata.

3. Në rastet e përmendura në pikën 2, të këtij neni, çdo hetim i njësisë përgjegjëse, nëse ka filluar, ndërpritet dhe sinjalizimi hetohet në vijim nga ILDKPKI. Në rast se nuk vërtetohen kushtet e përcaktuara në pikën 2 të këtij neni, njesia përgjegjëse, me vendim të arsyetuar, e dërgon sinjalizimin për nisjen ose vijimin e hetimit administrativ tek organi kompetent.

KREU IV HETIMI ADMINISTRATIV

Neni 9

Regjistrimi i sinjalizimit

1. Sinjalizimet regjistrohen në një regjistër të posaçëm protokolli dhe elektronik për regjistrimin e sinjalizimeve.

2. Njesia përgjegjëse nuk mund të refuzojë për asnjë shkak regjistrimin e sinjalizimit.

Neni 10

Parimet e hetimit administrativ

1. Në kryerjen e hetimit administrativ njesia përgjegjëse Bashkia Vau Dejes vepron:

a. me ndershmëri, paanshmëri dhe efikasitet, duke pasur parasysh interesat legjitim të sinjalizuesit;

b. në mënyrë të pavarur nga pikëpamja politike dhe çdo influencë tjetër e padrejtë që mund të pengojë realizimin e detyrave;

c. duke shmangur çdo konflikt interesi të mundshëm përpara fillimit të hetimit administrativ;

d. duke marrë të gjitha masat e përshtatshme për të mbrojtur dokumentacionin dhe provat lidhur me sinjalizimin nga zhdukja, fshehja, ndryshimi, falsifikimi dhe veprime të tjera, të cilat synojnë asgjësimin e tyre;

e. duke ruajtur konfidencialitetin e informacionit dhe të mbrojtë të dhënat në përmbajtje të çdo sinjalizimi;

f. duke ruajtur sekretin shtetëror në përmbajtje të një sinjalizimi, në zbatim të ligjit.

Neni 11

Procedura e hetimit administrativ

1. Njesia pergjegjese heton administrativisht sinjalizimin, në përputhje me procedurën e përcaktuar në ligjin nr. 60/2016. Për aq sa nuk parashikohet ndryshe në këtë ligj, njesia pergjegjese zbaton dispozitat e Kodit të Procedurave Administrative.
2. Njesia pergjegjese ka të drejtë të kërkojë informacione dhe dokumente, të urdhërojë inspektive ose analiza, të mbledhë deklarata ose të pyesë persona në dijeni ose rrethanat e çështjes ose të konsultohet me ekspertë të fushave të ndryshme.
3. Në hetimin administrativ merr pjesë sinjalizuesi dhe çdo person tjetër i tretë, kur dyshohet se posedon dokumente ose ka dijeni për rrethanat e sinjalizuara, përfshirë dhe të sinjalizuarin, nëse vlerësohet e nevojshme nga njesia pergjegjese.
4. Çdo pale pjesëmarrëse në hetimin administrativ i garantohet një proces i rregullt, në përputhje me parashikimet në Kodin e Procedurave Administrative, si dhe:
 - a. mund të japë deklarata me shkrim, argumente ose opinione;
 - b. mund të konsultohet me dosjen e hetimit;
 - c. ka të drejtë të dëgjohet në lidhje me pretendimet e tij.
5. Njesia pergjegjese njofton sinjalizuesin për çdo masë të marrë në përgjigje të sinjalizimit jo më vonë se 30 ditë nga momenti i kryerjes së veprimit. Pavarësisht nga afati i njoftimit të parashikuar në këtë pikë, njesia pergjegjese është e detyruar t'i përgjigjet brenda 30 ditëve nga marrja e kërkesës për informacion, të paraqitur me shkrim nga sinjalizuesi, në çdo kohë, në lidhje me çështjen e sinjalizuar prej tij.
6. Njesia pergjegjese merr masa të menjëhershme, të çastit dhe për aq sa është e mundur, për të parandaluar ose penguar vazhdimin e pasojave të dëmshme nga veprimi ose praktika e dyshuar e korrupsionit të sinjalizuar.
7. Nëse në përfundim të hetimit administrativ nga njesia pergjegjese rezulton se veprimi ose praktika e dyshuar e sinjalizuar përbën ose mund të përbëjë një shkelje administrative, sipas

ligjit, njesia pergjegjese sipas rastit, vë në dijeni organin kompetent.

Neni 12

Provat në hetimin administrativ

1. Njesia pergjegjese dokumenton çdo veprim që kryen gjatë hetimit administrativ. Dokumentet e nevojshme për hetimin administrative merren apo pranohen pa pagesë. Çdo shkelje e detyrimit të zyrtarëve apo të organizatave private për dhënie dokumentacioni shkresor apo dokumenti tjetër provues përbën shkak për fillimin e procedimit ligjor në varësi të shkeljes së konstatuar.
2. Njesia pergjegjese ka të drejtë të këqyrin sende, vende apo dokumentacion me qëllim fiksimin dhe dokumentimin e veprimeve apo të pasojave të veprimtarisë apo praktikës së dyshuar të korrupsionit. Dokumentimi mund të bëhet me procesverbal, me mjete të tjera fotografike e filmike apo në çdo mënyrë tjetër.
3. Në raste të veçanta, njesia pergjegjese vlerëson se ekzistojnë rrethanat për manipulimin apo asgjësimin e dokumenteve shkresore, njesia pergjegjese bllokoi dokumentacionin apo mjetet e tjera provuese. Zyrtarët përgjegjës apo personat e tjerë janë të detyruar të mos kryejnë asnjë veprim mbi këto dokumente gjatë gjithë kohës që ato janë të bllokuara. Në çdo rast mbahet një procesverbal, që nënshkruhet nga anetaret e njesise pergjegjese dhe zyrtarët përgjegjës apo personat e tjerë. Zhbllokimi i dokumentacionit bëhet me urdhër të Kryetarit të njesise pergjegjese.
4. Gjatë ushtrimit të detyrës njesia pergjegjese zbaton, për aq sa mund të jetë e përshtatshme, të gjitha mjetet dhe mënyrat provuese të parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative.
5. Në fund të kontrollit mbahet akt-kontrolli, i cili nënshkruhet nga njesia pergjegjese dhe zyrtarët e organit shtetëror apo personat drejtues në organizatat private. Në rast se këta të fundit nuk janë dakord me përmbajtjen e aktit kanë të drejtë të bëjnë vërejtje dhe të paraqesin kundërshtime. Kopje të argumenteve dhe të dokumenteve kundërshtuese i bashkëlidhen aktit.

Neni 13

Përfundimi i hetimit administrativ

1. Njesia pergjegjese përfundon hetimin administrativ nëse:

a. gjatë hetimit rezulton se sinjalizimi për veprimin ose praktikën e dyshuar të korrupsionit është i bazuar. Në këtë rast, njesia pergjegjese njofton menjëherë Prokurorinë ose Policinë e Shtetit.

b. sinjalizuesi nuk ka vepruar në kushtet e mirëbesimit, në zbatim të nenit 6 të ligjit nr.60/2016.

2. Në dosjen e sinjalizimit shënohen vendimi për përfundimin e hetimit administrativ nga njesia pergjegjese i arsyetuar për të gjitha shkaqet që kanë çuar në vendimmarrjen përkatëse, si dhe masat e marra në lidhje me sinjalizimin.

KREU V

RUAJTJA E KONFIDENCIALITETIT DHE TË DHËNAVE PERSONALE

Neni 14

Konfidencialiteti

1. Gjatë procedurës së hetimit administrativ të sinjalizimit identiteti i sinjalizuesit u bëhet i ditur personave të tretë vetëm me pëlqimin e tij me shkrim.

2. Njesia pergjegjese duhet të ruajë në çdo kohë në mënyrë konfidenciale informacionin e lidhur me sinjalizimin, duke mos e përhapur ose transmetuar tek persona të tretë, si dhe të mos e përdorin për qëllime të tjera, përveçse me pëlqimin me shkrim të sinjalizuesit ose për përmbushjen e një detyrimi ligjor.

3. Njesia pergjegjese në komunikimet me organizatën ku punon sinjalizuesi ose me çdo subjekt apo autoritet tjetër, privat ose shtetëror, respekton detyrimin e konfidencialitetit dhe ua komunikon informacionin e nevojshëm vetëm personave të caktuar për hetimin administrativ ose për marrjen e masave për ndjekjen e fakteve të sinjalizuara, në kuadër të një marrëveshjeje konfidencialiteti mes palëve.

Neni 15

Mbrojtja e të dhënave personale

1. Të dhënat personale të individëve të përfshirë në hetimin administrativ përpunohen vetëm për qëllim të ligjit nr. 60/2016. Në çdo rast, përpunimi i të dhënave personale kryhet sipas parimeve dhe procedurave të legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.
2. Në rastet kur, në zbatimin e këtij ligji, konstatohet mosrespektim i legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale, çështja i referohet Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

KREU VI

Neni 16

Afati për vendimmarrjen

1. Procedura e hetimit administrativ të sinjalizimit nga njësia përgjegjëse përfundon sa më shpejt të jetë e mundur ,por në çdo rast jo më vonë se 60 ditë nga data e fillimit të hetimit ,përveçse kur nga rrethanat kërkohet një afat më i gjatë.
2. Shtyrja e afatit për hetimin administrativ bëhet me vendim të arsyetuar të njësisë përgjegjëse duke përcaktuar edhe afatin e e ri kohor të shtyrjes në përputhje me vështirësinë dhe kompleksitetin e çështjes.

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë.

Punoi

Arta Paluku

Miratoi

KRYETARI

Kristian SHKRELI

